

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Banalizimi i protestës dhe elita e vjetër politike
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/banalizimi-i-protestes-dhe-elita-e-vjeter-politike-i585661
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 16:44:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 16:43:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f fe764c151300ded213a2dc36cbd9d902d6780fb4dbb08dc761777bdf735a38
TEKSTI	790245f8220880951d1e1e24b74312eaa962bc3fd7fed634aa365d7c156e5f50
PAMJA	27837f780b6f666b9eb1922241046e8ce21bddbdf41e27c6c1c31f0b8becb59e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c0afb7cb8746bd7974f5ce2acb5f6447bf658be6cdf8a7b9cb078b6173e7115c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5b654c1d1909c3ec2c270f06deb394b2c8c828a13f172059a527e1d310a57bcf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c0afb7cb8746bd7974f5ce2acb5f6447bf658be6cdf8a7b9cb078b6173e7115c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English



1 e [Banalizimi i protestes dhe elita e vjetër politike "S'ishim per te marre vendim". Çuçi per takimin ne Vlore: Njerezit nuk e kuptojne thelbin e Reformes Territoriale, mbledhje fundit](#)

Banalizimi i protestës dhe elita e vjetër politike



12 Shtator 2026, 18:43Blog Nga Skënder Minxhozi

Që një politikan të qëndrojë tre dekada e gjysëm në majë të politikës aktive e më pas të bëjë një udhëtim në SHBA e të thotë “u rinova, fillojmë nga e para”, kjo është një ironi e hidhur e dëshpëruese, fryt dhe produkt i një ambjenti pa rregulla e semaforë si Shqipëria. Udhëtimi i fundit i Sali Berishës në Amerikë është kthyer në një objekt humori, më shumë sesa në një mision të pamundur rikthimi. Megjithatë brenda kësaj fabule që të bën të qeshësh ka diçka serioze, e cila prek fenomenin e jo vetëm ngjarjen konkrete.

Kemi thënë deri në lodhje gjatë tranzicionit se në këtë vend asgjë nuk zhduket, por vetëm riciklohet. I përshtaten kësaj logjike të gjithë liderët e partive politike aktuale, duke nisur nga Sali Berisha, Ilir Meta e Fatmir Mediu (plus një gjysëm dyzine krerësh partish më të vogla), për të vijuar me Edi Ramën i cili hyri në politikë nga shtatë vjet pas tyre.

Elita politike e sotme e ka bërë kohën e saj dhe po jep shenja serioze plakjeje, aq sa edhe një politikan kompleks si Fatos Nano sot kujtohet më së pari për vullnetin për t’u dorëhequr nga postet e larta që mbante në momente të caktuara. Akte emancipuese të cilat nuk krijuan dot një kulturë të konsoliduar brenda klasës drejtuese shqiptare.

Sot asistojmë madje në fenomenin e kundërt me atë të heqjes dorë nga karriera. Shohim relativizim të partive në favor të konsolidimit dhe blindimit të postit të drejtuesit të partisë. Forumet partiake janë zbehur, demokracia e brendshme në parti është kthyer në një sport të rrezikshëm për atë që e tenton dhe figura e liderit është i vetmi far ndriçues që tregon rrugën. Një fushë me fidanësh luledielli që ndjekin lëvizjen e lëmshtit të zjarrtë në qiell, ja ç’janë partitë tona politike sot.

Ky lexim është tashmë i lehtë për t’u bërë. Është një kohë e gjatë e jetuar nga miliona shqiptarë gjatë tranzicionit. Një tunel që në vitet ‘90 kujtuam se ishte i shkurtër, por që me hidhërim konstatojmë se paska qenë më i gjatë se tuneli i La Manshit.

Në këtë mjedis një protestë qytetare që do të kontestonte këtë realitet të bllokuar, do të ishte e mirëpritur si një shkulum ajri i freskët në një dhomë me dritare të mbyllura. Një qëllim parimisht i kuptueshëm dhe normal për një vend që ka trokitur në dyert e Evropës, në të cilën përjetësia e politikanëve është një vijë e kuqe që nuk pranohet.

Protesta e flamengove e pati dhe e ka ende formalisht këtë pretendim vizionar. Ashtu si nuk e pati dhe nuk ka më gjasa që do ta ketë në të ardhmen një formulë konkrete sesi do t’i hapë dritaret e dhomës së mbyllur të politikës shqiptare. Në vend që të kërkonte, përzgjidhte, nxishte e afronte në radhët e saj trurin, dinjitetin, emrat e papërlirë dhe politikanët e nesërm mendjehapur, kjo protestë ka rënë me kalimin e muajve në hullinë e turbullt të dhunës verbale, anarshisë, banalitetit dhe sjelljes së dhunshme. Një turmë e vogël njerëzish inatçorë e disa herë vulgarë të cilët kujtojnë se Rama rrëzohet me bikerina vezësh dhe postime në rrjetet sociale – kjo është e vetmja histori e përditshme e përsëritur e protestës dikur të madhe, të paqte dhe po ashtu shumë të rrezikshme për elitën e vjetër drejtuese. Ata që prematuan të ardhmen nuk orientohen dot aktualisht as në të tashmen!

Kolegu Ilir Demalia pati disa ditë më parë idenë paksa aventureske, duke ditur pozicionimin e tij ndaj protestës, që të shkojë e të futet në mesin e protestuesve. I gjeti të grupuar në këmbët e zyrës së Ramës, teksa e shanin kryeministrin e vendit me fjalët më banale që njeh shqipja. Burra, gra, të rinj e të reja (me siguri edhe të mitur jo pak) dëgjonin korin e protestuesve që ulërinte duke sharë me fjalorin e një turme ultrasish në një stadium province. Demalia e “pagoi” në vend dhe pa vonesë aktin e tij, duke marrë pjesën e tij të sharjeve plot kolor, por kjo më shumë sesa për sedrat individuale që kjo turmë sharësish lëndoi, flet për degjenerimin gradual e të pandalshëm të kësaj lëvizjeje që kërkon të jetë emancipuese dhe bëhet destruktive, që kërkon të nxisë pjesëmarrjen dhe provokon largimin e braktisjen, që tenton të rrezikojë pushtetin politik dhe në fakt e konsolidon atë duke u shfaktorizuar vetë me banalitetin që rrezaton çdo ditë.

Nuk është tepri të thuash sot se një protestë të tillë në dyert e pushtetit do ta luste çdo qeveri dhe kryeministër. Një protestë që nuk të rrezikon me mllëfin “kaps” dhe fuklorin e saj, por që është aty si një dekor demokratik që mund ta shesësh në çdo kancelari evropiane si një provë e emancipimit të vendit!

Ndërkohë që nuk po i merr dot pushtetin, protesta po i jep Edi Ramës luksin e papritur që të miklojë sedrën e vet duke këqyrrur sesi qindra veta e mallkojnë çdo ditë në dyert e zyrës, por pushkët i kanë prej druri kurse fishekët i kanë mësimorë. Nuk paska më keq se një lëvizje që niset të bëjë historinë dhe që e sheh veten si dekor të pushtetit që pretendon të rrëzojë prei 100 ditësh!

Besnik Dizdari, si dëshmi e kohës kur gazetaria ishte një profesion

18:30 Blog

Pazarokracia

17:16 Blog / 3 komente

[Unë jam me Petrit Malajn](#)

14:45 Blog / 45 komente

[John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankand?](#)

11:40 Blog / 19 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.